



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 2 maj 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjeve të Mëtejshme dhe Çështje të Lidhura me To

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 21(4), 39(4) dhe (5) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullave 90(3) dhe 92 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi² aktakuzën e paraqitur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”),³ lëshoi fletarrestime për Hashim Thaçin (“z. Thaçi”),⁴ Kadri Veselin (“z. Veseli”),⁵ Rexhep Selimin (“z. Selimi”)⁶ dhe Jakup Krasniqin (“z. Krasniqi”)⁷ (bashkërisht, “të akuzuarit”) dhe urdhëroi transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”).⁸

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020, F00026/RED.

³ KSC-BC-2020-06, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për Konfirmim*, 24 prill 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Më 24 korrik 2022, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e rishikuar, F00011/A01. Versioni i redaktuar publik u njoftua më 18 nëntor 2020, F00011/RED.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00027/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për Hashim Thaçin*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 nëntor 2020, F00027/A01/RED.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00027/A03, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për Kadri Veselin*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 nëntor 2020, F00027/A03/RED.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00027/A05, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për Rexhep Selimin*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 nëntor 2020, F00027/A05/RED.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00027/A07, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për Jakup Krasniqin*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; versioni i korrigjuar u dorëzua më 28 tetor 2020, F00027/A07/COR, dhe versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 nëntor 2020, F00027/A07/COR/RED.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00027/A02, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Transferim në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 nëntor 2020, F00027/A02/RED (për z. Thaçi). F00027/A04, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Transferim në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*,

2. Më 9-11 nëntor 2020, pas transferimit të tyre në DHS,⁹ u mbajtën paraqitjet e para për z. Krasniqi,¹⁰ z. Thaçi¹¹, z. Veseli,¹² dhe z. Selimi.¹³ Gjatë paraqitjeve të tyre të para, të akuzuarit deklaruan se e kuptonin dhe e flisnin gjuhën shqipe.¹⁴

3. Më 3 shtator 2021, ZPS-ja dorëzoi një aktakuzë të ndryshuar për konfirmim nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake (“Aktakuza e Ndryshuar”).¹⁵

26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 nëntor 2020, F00027/A04/RED (për z. Veseli). F00027/A06, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Transferim në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 nëntor 2020, F00027/A06/RED (për z. Selimi). F00027/A08, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Transferim në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; versioni i korrigjuar u dorëzua më 28 tetor 2020, F00027/A08/COR, dhe versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 nëntor 2020, F00027/A08/COR/RED (për z. Krasniqi).

⁹ KSC-BC-2020-06, F00048, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Jakup Krasniqit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 4 nëntor 2020, publik, me shtojcën 1, publike. F00053, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Hashim Thaçit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe mbi Emërimin e Mbrojtësit*, 5 nëntor 2020, publik, me shtojcën 1, publike dhe shtojcën 2, konfidenciale. F00054, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Kadri Veselit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe mbi Emërimin e Mbrojtësit*, 5 nëntor 2020, publik, me shtojcën 1, publike dhe shtojcën 2, konfidenciale. F00055, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Rexhep Selimit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 5 nëntor 2020, publik, me shtojcën 1, publike.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00052, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe për Çështje lidhur me Të*, 5 nëntor 2020, publik, para. 20(a). Shih gjithashtu, transkripti, seanca e datës 9 nëntor 2020, publik, f. 1.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00057, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështje të lidhura me Të*, 6 nëntor 2020, publik, para. 20(a). Shih gjithashtu, transkripti, seanca e datës 9 nëntor 2020, publik, f. 25.

¹² KSC-BC-2020-06, F00060, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështje të lidhura me Të*, 6 nëntor 2020, publik, para. 20(a). Shih gjithashtu, transkripti, seanca e datës 10 nëntor 2020, publik, f. 56.

¹³ KSC-BC-2020-06, F00061, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështje të lidhura me Të*, 6 nëntor 2020, publik, para. 20(a). Shih gjithashtu, transkripti, seanca e datës 11 nëntor 2020, publik, f. 76.

¹⁴ KSC-BC-2020-06, Transkripti, 9 nëntor 2020, f. 4, rreshti 22 deri f. 5, rreshti 9; dhe f. 29, rreshtat 12-22; Transkripti, 10 nëntor 2020, f. 59, rreshtat 18-25; Transkripti, 11 nëntor 2020, f. 79, rreshti 17 deri f. 80, rreshti 4.

¹⁵ KSC-BC-2020-06, F00455, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesës për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-5, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik, përkatësisht F00455/CONF/RED dhe F00455/RED, u dorëzuan më 8 shtator 2021.

4. Më 22 prill 2022, pasi kishte urdhëruar¹⁶ palët të dorëzonin përgjigjet e tyre dhe kishte marrë përgjigjet (“Përgjigjet e Mbrojtjes”)¹⁷ dhe kundërpërgjigjen (“Kundërpërgjigja e ZPS-së”)¹⁸ në lidhje me nëse materiali mbështetës për ndryshimet, që gjykohej se përbënin akuza të reja mbështeste konstatimin e ekzistencës së një dyshimi të bazuar mirë në pajtim me rregullën 86(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi Aktakuzën e Ndryshuar (“Vendimi i Ndryshimit”).¹⁹

5. Më 29 prill 2022, ZPS-ja dorëzoi versionin e redaktuar publik të Aktakuzës së Ndryshuar dhe dokumentet përkatëse.²⁰

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Sipas nenit 39(4) të Ligjit, personi kundër të cilit është konfirmuar aktakuza, në pajtim me një urdhër ose fletarrestim të lëshuar nga Dhomat e Specializuara (nëse nuk është tashmë në paraburgim), ndër të tjera, informohet menjëherë për akuzat kundër tij ose saj.

7. Sipas nenit 39(5) të Ligjit, gjatë shqyrtimit fillestar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lexon aktakuzën, bindet se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar,

¹⁶ KSC-BC-2020-06, F00635, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim lidhur me Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesën për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 23 dhjetor 2021, konfidencial, para 48, 53(d), (e). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 15 shkurt 2022, F00635/RED.

¹⁷ KSC-BC-2020-06, F00666, Mbrojtësi i Specializuar, *Mocion i Mbrojtjes së Thaçit nëse Ekziston Dyshimi i Bazuar Mirë në lidhje me Kërkesën e ZPS-së për Ndryshim të Aktakuzës*, 31 janar 2022, konfidencial; F00668, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime të Mbrojtjes së Veselit për Materialin Mbështetës të dorëzuar nga ZPS-ja në lidhje me Kategorinë e Parë dhe Kategorinë e Dytë të Ndryshimeve në Aktakuzë*, 31 janar 2022, konfidenciale; F00669, Mbrojtësja e Specializuar, *Parashtrime të Mbrojtjes së Krasniqit në Pajtim me Vendimin KSC-BC-2020-06/F00635*, 31 janar 2022, konfidenciale.

¹⁸ KSC-BC-2020-06, F00680, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë në lidhje me Kërkesën për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 4 shkurt 2022, konfidenciale.

¹⁹ KSC-BC-2020-06, F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 185(a) dhe (b). Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua në të njëjtën ditë, F00777/RED.

²⁰ KSC-BC-2020-06, F00789, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar dhe Dokumenteve lidhur me Të*, 29 prill 2022, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, Shtojcat 2-4, konfidenciale dhe Shtojcat 5-7, publike.

konfirmon se i akuzuari e kupton aktakuzën dhe e udhëzon të akuzuarin që të deklarohej për fajësinë ose pafajësinë e tij.

8. Sipas rregullës 90(3) të Rregullores, nëse aktakuza e ndryshuar përfshin akuza të reja, dhe i akuzuari tashmë është paraqitur para një paneli në pajtim me rregullën 92 të Rregullores, paraqitja vijuese organizohet sa më shpejt që të jetë e realizueshme.

III. DISKUTIM

9. Duke pasur parasysh se Aktakuza e Ndryshuar kundër të akuzuarve është konfirmuar dhe duke vënë në dukje se ata tashmë janë në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të përshtatshme të mbajë seanca veç e veç të paraqitjeve të mëtejshme të të akuzuarve të martën, më 10 maj 2022, si më poshtë:

z. Thaçi: 10 maj 2022 në orën 10:00-10:45

z. Veseli: 10 maj 2022 në orën 11:15-12:00

z. Krasniqi: 10 maj 2022 në orën 14:00-14:45

z. Selimi: 10 maj 2022 në orën 15:15-16:00

10. Mbrojtësi i viktimave ftohet të marrë pjesë në secilën nga seancat e paraqitjeve të mëtejshme të të akuzuarve, nëse dëshiron.²¹

11. Nëse mbrojtësit dhe/ose ndonjë nga të akuzuarit dëshirojnë të paraqiten përmes videolidhjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon mbrojtësit dhe/ose të akuzuarit që ta bëjnë këtë. Çdo kërkesë për të marrë pjesë në paraqitjet e mëtejshme përmes videolidhjes duhet t'i parashtrahet drejtpërsëdrejti Administratores, në përputhje me Udhëzuesin e Punës së Zyrës Administrative për Videolidhjet (KSC-BD/23/COR, dhe në kohë të mjaftueshme paraprakisht që Administratorja të

²¹ KSC-BC-2020-06, F00257, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 21 prill 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F00257/RED.

ndërmarrë hapat e duhur dhe të informojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake.²² Sipas praktikës së zakonshme, të akuzuarit gjithashtu udhëzohen të paraqesin kërkesë, nëse dëshirojnë të marrin pjesë në paraqitjet e mëtejshme përmes videolidhjes.

12. Së fundi, duke pasur parasysh parashtrimin së fundmi nga ZPS-ja të versionit të redaktuar publik të Aktakuzës së Ndryshuar dhe dokumenteve të lidhura me të, dhe për përgatitjen e shpejtë të versionit të redaktuar publik të Vendimit të Ndryshimit, Mbrojtja dhe ZPS-ja urdhërohen të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të Përgjigjeve të Mbrojtjes (F00666, F00668 dhe F00669) dhe Kundërpërgjigjes së ZPS-së (F00680) deri të premten, 6 maj 2022, në orën 12:00.

IV. VENDIM

13. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **VENDOS** të mbajë seancat e paraqitjeve të mëtejshme të të akuzuarve **të martën, më 10 maj 2022**, siç përcaktohet në paragrafin 9 më lart;
- b) **AUTORIZON** mbrojtësit dhe/ose të akuzuarit që të paraqiten përmes videolidhjes nëse i bëjnë kërkesë Administratores në përputhje me paragrafin 11, sa më shpejt që të jetë e realizueshme;
- c) **URDHËRON** Administratoren që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për organizimin e videolidhjes në koordinim me mbrojtësit, sipas rastit; dhe
- d) **URDHËRON** palët që të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të Përgjigjeve të Mbrojtjes (F00666, F00668 dhe F00669) dhe Kundërpërgjigjes së ZPS-së (F00680) deri **të premten, 6 maj 2022, në orën 12:00**.

²² Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, F00062, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Autorizim të Pjesëmarrjes përmes Videolidhjes*, 6 nëntor 2020, publik, para. 10; F00069, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Autorizim të Pjesëmarrjes përmes Videolidhjes*, 9 nëntor 2020, publik, para. 9.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 2 maj 2022
Në Hagë, Holandë.